



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: MBROJTJE LUMORE VRISI BAJKAJ, BASHKIA DELVINË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për kanale kulluese 45247112-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 56.766.528,42 *(pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqindë e njëzetë e tetë presje dyzetë e dy)* **Lekë, pa TVSH.**

- Ky objekt bashkëfinancohet nga Bashkia Delvinë dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (Ministria e Mbrojtjes), bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 28.05.2026, protokolluar pranë nesh me Nr. 1502 Prot, datë 02.06.2026 : “Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2026 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontaktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, (bashkëlidhur shtojca Nr.1), shkresës Nr. 1609 Prot, datë 16.07.2026, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile protokolluar pranë nesh me Nr.2081, datë 20.07.2026 si dhe deklaratës së bashkëfinancimit Nr. 640 Prot, datë 27.02.2026 nga ana e Bashkisë Delvinë.
- **Financimi për Vitin 2026 do të jetë 24.523.149 (njëzetë e katër milionë e pesëqindë e njëzetë e tre mijë e njëqindë e dyzetë e nëntë) Lekë me TVSH.**
- Financimi i AKMC – 24.523.149 (njëzetë e katër milionë e pesëqindë e njëzetë e tre mijë e njëqindë e dyzetë e nëntë) Lekë.

- Financimi i NJQV – 0 (zero) lekë.
- **Financimi për Vitin 2027 do të jetë 43.596.685,10 (dyzetë e tre milionë e pesëqindë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqindë e tetëdhjetë e pesë presje dhjetë) Lekë me TVSH.**
- Financimi i AKMC – 29.972.737,59 (njëzetë e nëntë milionë e nëntëqindë e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqindë e tridhjetë e shtatë presje pesëdhjetë e nëntë) Lekë.
- Financimi i NJQV – 13.623.947,51 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqindë e njëzetë e tre mijë e nëntëqindë e dyzetë e shtatë presje pesëdhjetë e një) lekë.

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës për këtë procedurë prokurimi është bërë duke iu referuar preventivit të hartuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë (Njësia e Prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vendosur të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 datë 23.09.2024 të miratuar nga APP.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Kriteri (1-a) është vendosur në bazë të neneve 76, 77 dhe 82 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 82 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe pikën 1 të nenit 30 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, (Shtojca 7).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e Operatorit Ekonomik sipas “Shtojcës 8”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2023, 2024 dhe 2025), ku vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe në proporcion me vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP-së parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Në nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiarë.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Sa më sipër, duke qenë se lloji i procedurës është “E Hapur”, është kërkuar që vlera minimale e xhiros vjetore për tu përmbushuar nga operatorët ekonomikë të jetë sa vlera limit i kontratës.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; si dhe Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë bazuar ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.**

Në nenin 41 të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar përcaktohet se:

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqindë milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE), çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së

(Kriteri 2.2.3 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme, të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë punimesh;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat të shoqëruar me:
 - Kontratë punimesh;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera;
 - Faturë tatimore të situacionit përfundimtar

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me preventivin e ndarjes së punimeve që ka marrë përsipër të kryejë secili operator ekonomik në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77, pika 4 të LPP-së, ndër të tjera parashikohet se: Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomik të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, prandaj bazuar edhe në nenin 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kërkesa se për kontratat e realizuara si nënkontraktor, duhet të paraqitet kontrata bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor/Investitorit, si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor/investitorit, bazohet në nenin 127 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dispozitat e kodit civil, neni 857. Në nenin 127 të LPP-së, pika 3 parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cënuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Në nenin 857 të Kodit Civil parashikohet se: Sipërmarrësi nuk mund të japë me nënsipërmarrje kryerjen e veprës ose kryerjen e shërbimeve, pa u marrë pëlqimi nga porositësi.

Kërkesa se për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit, ka për qëllim të bëjë një vlerësim korrekt të kriterit për paraqitjen e kontratave të ngjashme. Kjo kërkesë bazohet edhe në parashikimet e nenit 88 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për paraqitjen dhe përmbushjen e kërkesave për kualifikim, e konkretisht:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomik, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontratë bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P - 1 A Punime gjurmimi në tokë.

N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

N.P - 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

Për punimet speciale të ndërtimit:

N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S - 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- *profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- *Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 5 vitet e fundit si shoqëri;*
- *Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;*
- *Kapacitetet financiare.*

Kategoritë e licensave janë përcaktuar në bazë të zërave të përshkruara në preventivin e projektit;

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim dheu me eskavator me zingjir sipas preventivit... Gërmim dheu me krahë në seksion të detyruar sipas preventivit.....	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Punime shtresash me zhavor lumi dhe stabilizant dhe shtresë çakëlli mbeturinë kave sipas preventivit..... Shtresë asfaltobetoni dhe punime asfaltimi në rrugë me shtresë binderi me granil gur kave sipas preventivit	A	0-20 milion
NP-7	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Punime për veprën e kanalit kullues (ndërtimi i veprave të artit +kanalizime), mbushje gur kave, ndërtimi dhe mbushja e gabionave me rrjetë teli të zinguar, punime betoni dhe betonarmeje, punime hekur betoni, etj.... sipas preventivit	B	21-50 milion
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje shtresash betoni sipas preventivit....	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punimet topogjeodezike për ndërtimin dhe pozicionimin e kanalit të ri kullues dhe gjurmës së rrugë	A	0-20 milion

		<i>automobilistike që kalon ngjitur me kanalin e dëmtuar si rezultat i përmytjeve si dhe të gjitha punimet mbështetëse që paraqesin nevojën e punimeve të tilla sipas projektit të zbatimit</i>		
--	--	---	--	--

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën dhe listpagesat e shoqërisë dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në UKM Nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se Për projekte me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt, i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Një punësim mesatar për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026, i të paktën 30 (tridhjetë) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në nenin 77 të LPP-së ndër të tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në nenin 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM-në Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, VKM-në Nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të

kantierit; VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar; Urdhërin Nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit; ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar; grafikun e punime, zërat e punimeve të preventivit, volumet për këto zëra. **Duke e bazuar në këto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (Inxhinierët), një numër minimal punonjësish të kualifikur për çdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjësish të thjeshtë/ndihmës. Nga ky numër rezultoi se për të përfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një punësim mesatar prej 30 punonjësish ku përfshihen (stafi kryesor teknik + punonjës të kualifikuar + punonjës të thjeshtë/ndihmës).**

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026, si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 1(një). |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1(një). |
| - Inxhinier Gjeodet/Topograf | 1(një). |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së Nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori i Shoqërisë

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

<i>1 (një) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të gjitha aspekteve të projektit për objektin që do të ndërtohet. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një tipologji të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, ndërtimi i veprave të artit, punimet e shtresave, punime betoni dhe hekuri, punime asfaltimi etj. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike, standartet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. (Punime Gërmimi, Prishje, Punime asfaltimi), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-4, NS-1.</i>
<i>1 (një) Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve për ndërtimin e vprave të artit + kanalizimet si dhe çdo punimi tjetër në fuksion të kanalit kullues etj, të cilave i korrespondon kategoria NP-7.</i>
<i>1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf</i>	<i>Është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimin dhe pozicionimin e kanalit të ri kullues dhe gjurmës së rrugë automobilistike që kalon ngjitur me kanalin e dëmtuar dhe të gjitha punimet mbështetëse që paraqesin nevojën e punimeve të tilla sipas projektit të zbatimit. Është përgjegjës për zbatimin e punimeve topogjeodezike, punime që përfshihen në kategorinë NS-18</i>

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:

- 2 (dy) Punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) Punonjës të specializuar për montimin dhe mbushjen e gabionëve
- 2 (dy) Punonjës të specializuar për shtrimin e asfaltit/asfaltobetonit
- 1 (një) Punonjës teknik/specialist topograf.
- 2 (dy) Karpentier
- 2 (dy) Hekurkthyes/hekurpunues
- 2 (dy) Betonues
- 4 (katër) Shofer
- 2 (dy) Manovrator
- 5 (pesë) punonjës të thjeshtë/ndihmës

- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit. **(Me përjashtim të Shoferëve dhe Manovratorëve në rastin e marrjes së mjeteve me qera).**
- Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Certifikatat/diplomat/dëshmia të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH” i ndryshuar.
- Për teknikët e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licencë profesionale nga institucionet përkatëse.
- Për Shoferët të paraqitet Leja e Drejtimit dhe CAP
- Për Manovratorët të paraqitet DAP
- Për profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet të plotësoj tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit	Emri i Institucionit publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Numri identifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

- Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licencuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licencimin/akreditimin e tyre.
- Në rast se operatori ekonomik i disponon mjetet e rënda në pronësi, manovratorët duhet të jenë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.
- Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin, kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga DPSHTRR, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Shënim: Në rastin kur makineritë disponohen me qera disponimi i drejtuesve/manovratorëve për këto mjete nga ana e operatorit ekonomik mund të rregullohet edhe nëpërmjet mënyrës së kontraktimit të tyre.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, siç janë gërmimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muraturës etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punëtorët dhe ndjek ecurinë e tyre gjatë kohës së punës.
- **Punonjësi i specializuar për montimin dhe mbushjen e gabioneve** janë të nevojshëm për montimin dhe ndërtimin e gabionave me rrjetë teli dhe gur kave, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës të specializuar për shtrimin e asfaltit/asfaltobetonit** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve mbështetëse për shtrimin e shtresave të asfaltobetonit dhe shtresës së binderit në trupin e rrugës
- **Tekniku topograf** është i nevojshëm për për realizimin e punimeve të piketimit, matjeve të tjera të ngjashme, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit duke asistuar me drejtuesin teknik.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, sipas zërave të preventivit. Bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të kanalit, muret e betonit, ndërtojnë armaturën, kallëpet, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Hekurkthyesi/hekurpunues** është i nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipas zërave të preventivit. Ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë sipas strukturës, në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos.
- **Shoferi** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamionë, kamionçina. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun dhe numrin e mjeteve që duhen për transportin e materialeve të

ndërtimit të dala nga prishja, si dhe transportin e materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit.

- **Manovratori eskavatorist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **eskavator gjermimi dhe fadroma të të gjitha llojeve**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, gërma a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë: (a) - eskavator gjermimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për “**Eskavatoristë**”
- **Punonjësit e thjeshtë/ndihmës** do të realizojnë punimet e prishjes së shtresave të betonit, si dhe çdo punë ndihmëse sipas preventivit të projektit nën mbikëqyrjen e drejtuesve kryesor teknik dhe punonjësve të kualifikuar.

Punonjësit e thjeshtë/ndihmës do të jenë prezent gjatë gjithë kohës në kantier dhe do të kryejnë çdo punë ndihmëse që iu caktohet nga drejtuesit e projektit dhe punonjësit e kualifikuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit, të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 120 (njëqindë e njëzetë) Ditë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.8 Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-në Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", i ndryshuar.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (I ndryshuar)

Shënim: Disponimi i punonjësve të mësipërm nga ana e operatorit ekonomik mund të rregullohet edhe nëpërmjet mënyrës së kontraktimit të tyre.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Këto kriterë janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM-në Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarrëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e specialistëve të certifikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve. Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë mbrojtjen e mjedisit, garantimin e një produkti final eficient në drejtim të mjedisit ka gjykuar që të jetë staf mbështetës 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (I ndryshuar). Përsa i përket punonjësit përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit Nr 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit. Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperiencë, duhet të vlerësojë rëndësinë e projektit, rritjen e performancës së realizimit të objektit, duke mbrojtur punonjësit dhe mjedisin, gjë që siguron në mënyrë të përbashkët suksesin e realizimit të këtij projekti.

2.3.9 Operatori/et ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të ketë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licencuara. Mbështetur në: Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.

Argumentimi: Kriteri për licencën e lëshuar nga QKL me kodin III. 2. B është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertoj të jetë i pajisur me certifikatat e mësipërme ose të ketë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara me licencën e lartpërmendur,

të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zotëron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta, gjatë kryerjes së veprimtarisë ose të kenë këtë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licencuara si më sipër. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbetjeve inerte i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Kërkesa për të paraqitur akt miratimin është bërë për të verifikuar nëse mbetet që do të largohen janë të përcaktuara në licencën e subjektit për tu administruar dhe transportuar.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015).
- b) Certifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015.
- c) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/45001-2023, ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 45001-2018/45001-2023.
- d) Certifikatën e cilësisë sipas standartit SSH BS PAS 99:2012 ose Ekuivalent të tij (Sistemi i menaxhimit të integruar, e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës të zërave të punës të marra përsipër sipas Akt Marrëveshjes së Bashkimit

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e

cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 ose ekuivalente me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të siguri dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me 45001-2018/45001-2023 ose ekuivalente me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e siguri dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbytjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

PAS 99 Objektivi kryesor i standardit PAS 99:2012 është të sigurojë një kuadër të përbashkët për integrimin dhe menaxhimin e sistemeve të ndryshme të menaxhimit brenda një organizate. Zakonisht në praktikë ky standart synon që organizata të mund të integrojë sisteme si ISO 9001 “Menaxhimi i Cilësisë”, ISO 14001 “Menaxhimi Mjedisor” si dhe ISO 45001/OHSAS 18001 “Shëndeti dhe siguria në punë”

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Mjete/pajisje teknike	Statusi	Njësia	Sasia
1	Automjet vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton	Pronësi/Qera	copë	2
2	Eskavator me zhinxhir	Pronësi/Qera	copë	2
3	Minieskavator me goma	Pronësi/Qera	copë	1
4	Fadromë me goma	Pronësi/Qera	copë	2
5	Autobetoniere	Pronësi/Qera	copë	2
6	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 7.5 Ton	Pronësi/Qera	copë	2
7	Kamion vinç	Pronësi/Qera	copë	1
8	Asfaltoshtuese	Pronësi/Qera	copë	1
9	Badibald/Kompator	Pronësi/Qera	copë	1
10	Aparat topogjeodezik me GPS	Pronësi/Qera	copë	1
11	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qera	copë	1
12	Jelek pune, (minimumi)	Pronësi/Qera	copë	10
13	Kokore pune, (minimumi)	Pronësi/Qera	copë	10
14	Komplet i ndihmës së shpejtë, (minimumi)	Pronësi/Qera	copë	2

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes ose kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve.

Në nenin 77 të LPP-së ndër të tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në nenin 39, pika 6/d), të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën..

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM-në Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Autoritetit Kontraktor kërkon nga ana e Operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe pajisjet teknike**. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

2.3.12 Operatorët ekonomik duhet të kenë në pronësi/kontratë qeraje/kontratë furnizimi 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerasë/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Shënim: Në rastin kur Fabrika e betonit do të jetë me Kontratë Furnizimi paraqitja e lejes mjedisore dhe dokumentave të tjerë të fabrikës nuk janë kusht, por duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me subjektin përkatës (e vlefshme)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve për produktin beton, si struktura të holla monolite betoni C16/20 etj, të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së punimeve për këtë zë.

2.3.13 Operatorët ekonomik duhet të kenë 1 (një) Gurore për shfrytëzimin e llojit mineral gëlqeror, pllakor që bën pjesë në llojin e mineraleve ndërtimore (inert), e cila duhet të jetë e pajisur me dokument pronësie dhe leje IV.1.B.2, shoqëruar me akt miratimet e lejeve lëshuar nga autoritetet e autorizuar me ligj.

Në rastin kur operatorët ekonomik kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet kontrata e qirasë (e vlefshme) apo kontrata e furnizimit (e vlefshme)

Shënim: Në rastin kur Gurorja do të jetë me Kontratë Furnizimi paraqitja e lejes dhe dokumentave të tjerë të saj nuk janë kusht, por duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me subjektin përkatës (e vlefshme)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve për produktin Gur kave, si mbushje me gur kave, gabiona me rrjetë teli të zinguar me gur kave, të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së punimeve për këto zëra në preventiv.

2.3.14 Operatorët ekonomik duhet të kenë në pronësi/kontratë qeraje/kontratë furnizimi 1 (një) fabrikë/linjë asfalti, e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerasë/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL.

Për linjën e prodhimit të asfaltit operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport vetëmonitorimi, Planvendosjen si dhe Çertifikatën e Kalibrimit.

Gjithashtu operatori ekonomik duhet të garantojë që asfalti i prodhuar të transportohet dhe të arrijë në kantier në temperaturën e kërkuar për shtrimin (jo më pak se 140° në momentin e shtrimit), pavarësisht distancës së fabrikës nga kantieri. Për këtë qëllim operatori duhet të disponojë mjete transporti të asfaltit (kamionë termo), të izoluar termikisht dhe kur është e nevojshme me sistem ngrohës ose mbulesë automatike në mënyrë që të sigurohet ruajtja e temperaturës dhe cilësisë së materialit gjatë transportit.

Shënim: Në rastin kur Fabrika/linja e asfaltit do të jetë me Kontratë Furnizimi paraqitja e lejes mjedisore dhe dokumentave të tjerë të fabrikës nuk janë kusht, por duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me subjektin përkatës (e vlefshme)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen

në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve të asfaltimit, shtresë asfaltobetoni me garanil guri kave, shtresë binderi me granil gur kave, sipas preventivit të punimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij, duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP-së, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit Nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendimin e KM Nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Shënim: Në zbatim të nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në Dokumentat e Tenderit, Preventiv, Specifikime Teknike, Raport Teknik, Relacion apo çdo dokument tjetër shoqërues është cituar ndonjë markë prodhimi, burim specifik, etj etj... për referenca të tilla (nqs ka) përfshihet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në çdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi për zbatimin e projektit, ekzekutimin e punëve dhe/ose përdorimin e produkteve dhe nuk ka asnjë efekt kufizues/përjashtues.

Shënim: Nisur nga fakti që ekzistojnë standarte ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standartit SSH/UNI/EN, mbi konformitetin e standartit europian, të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e këtyre kriterëve për kualifikim dhe vendosi vazhdimin e mëtejshëm i procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)